



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D' Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax: +355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr.doc. 202300183/3

Tiranë ___/___/2023

Lënda : *Përcillen sugjerimet në lidhje me Kapitullin VII të Draft-Konventës së Këshillit të Evropës për inteligjencën artificiale, të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.*

MINISTRISË SË BRENDSHME

Të nderuar,

Vitet e fundit, përdorimi i inteligjencës artificiale po gjen zhvillim dhe zbatim me ritme tejet të shpejta, teksa raporti mes zhvillimit dhe përdorimit gjithnjë e më tepër të sistemeve inteligjente dhe ligjit është në përpjestim të zhdrejtë, sa i takon zhvillimit të kuadrit të duhur ligjor në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar. Në këtë kuptim, tashmë prej disa kohësh ka përpjekje të vazhdueshme për të kuptuar ndikimin që ka aplikimi i sistemeve inteligjente në të drejtat e njeriut, dhe për t'a përkthyer këtë marrëdhënie në gjuhën e ligjit. Nevoja për rregullimin juridik dhe institucional të çështjeve që burojnë nga përdorimi gjithnjë e më i shpeshtë i inteligjencës artificiale në të gjithë aspektet e jetës së përditshme, në përpjekje për të dominuar efektet e padëshirueshme që mund të burojnë nga keqpërdorimi i qëllimshëm apo pakujdesia njerëzore, është absolutisht e domosdoshme.

Nga kjo pikëpamje, vëmendja që po i kushtohet ndikimit të inteligjencës artificiale (AI) në të drejtat e njeriut është një temë me rëndësi në rritje dhe një prioritet strategjik për strukturat në nivel kombëtar por edhe ndërkombëtar. Aktualisht, në Evropë po zhvillohen dy procese kryesore që synojnë të rregullojnë impaktin e inteligjencës artificiale: Akti i BE-së për Inteligjencën Artificiale, dhe diskutimet e Komitetit të Këshillit të Evropës për AI (CAI) për një Konventë (Kuađer) për AI, të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

Procesi i konsultimit për hartimin e kësaj konvente përfshin shumë aktorë si nivelin Evropian, ashtu edhe në nivel kombëtar, duke synuar transparencën e procesit, por njëkohësisht edhe dhënien e mundësisë për të gjithë palët që të japin kontributin e tyre gjatë diskutimeve që zhvillon Komiteti për dispozitat e Konventës që po hartohet.

Roli i institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut në këtë proces konsiderohet veçanërisht i rëndësishëm, si struktura të ndërmjetme të cilat mund të nxisin politikat e duhura, por edhe të ndërmjetësojnë përfaqësimin e shteteve pranë Komitetit të Këshillit të Evropës për AI (CAI). Veprimtaria e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut në këtë drejtim koordinohet nga Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (në vijim ENNHRI). Roli i ENNHRI-t në këtë komitet është ai i vëzhguesit. ENNHRI gjithashtu koordinon një grup të posaçëm me përfaqësues që mbulojnë çështjet e inteligjencës artificiale nga çdo institucion kombëtar i të drejtave të njeriut (NHRI) në nivel Evropian. Nëpërmjet këtij angazhimi të përbashkët mes ENNHRI dhe institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut synohet forcimi i rolit të mekanizmave në nivel kombëtar, për të siguruar që aplikimi i inteligjencës artificiale të mos bjerë ndesh me të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

Për këtë qëllim, është rekomanduar nga ENNHRI dhe krjimi i urave të komunikimit mes institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut dhe përfaqësuesve të shtetit në Komitetin e Inteligjencës Artificiale. Në këtë kuadër, jemi informuar nga ENNHRI se pika e kontaktit dhe përfaqësuese e shtetit shqiptar në këtë komitet është: *Znj. Sabrina QYPI – Nëpunëse e Departamentit të Analizës Kriminale dhe Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.*

Aktualisht, nisur nga fakti se dispozitat e draft-konventës janë në proces të konsultimit publik, dhe gjatë vitit 2023 do të zhvillohen disa seanca plenare para finalizimit të saj, ENNHRI do të përcjellë në vijimësi rekomandime për kapitujt e ndryshëm të Konventës, sipas axhendës së planifikuar për diskutim në mbledhjet plenare të Komitetit. Institucioni i Avokatit të Popullit, si institucion kombëtar i të drejtave të njeriut, do të përcjellë në vijimësi pranë Ministrisë së Brendshme (si ministria përgjegjëse që ka në varësi dhe përfaqësuesin e shtetit shqiptar në Komitetin e Inteligjencës Artificiale) sugjerimet përkatëse për qendrimet e shtetit për kapitujt të ndryshëm të konventës që është në proces konsultimi.

Në këtë kuadër, lidhur me Kapitullin VII të Draft-Konventës, i cili trajton rëndësinë e mbikëqyrjes së pavarur dhe forcimit të mekanizmave përkatës, evidentohet se dispozitat aktuale janë mjaft të kufizuara dhe nevojitet përputhshmëria e tyre me të drejtat, detyrimet dhe praktikat ekzistuese. Konkretisht, për këtë qëllim sugjerohet të përcillen si mesazhe kryesore çështjet si vijon:

1. Të nxirret në pah roli i institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut për mbikëqyrjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës, përfshirë dhe zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në momentin e caktimit të autoritetit përgjegjës që do të mbikëqyrë zbatimin e Konventës për Inteligjencën Artificiale në nivel kombëtar, shtetet duhet të konsultohen me institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (IKDNJ) dhe të vlerësojnë mundësinë e caktimit të një autoriteti të pavarur ekzistues (mundësisht IKDNJ) si autoritet mbikëqyrës në nivel kombëtar. Bashkëpunimi mes institucioneve shtetërore dhe IKDNJ duhet të institucionalizohet.
2. Konventa duhet të përfshijë kërkesa specifike për sa i takon pavarësisë formale dhe funksionale të autoriteteve mbikëqyrës në nivel kombëtar, në përputhje me standardet ekzistuese sa i takon strukturave të pavarura për të drejtat e njeriut, sipas Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për zhvillimin dhe forcimin e institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ)¹. Rekomandimi thekson potencialin dhe ndikimin e madh të IKDNJ-ve për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Evropë, veçanërisht për zbatimin efektiv të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), duke përfshirë ndërhyrjet e palëve të treta përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe komunikimet në lidhje me mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve. Rekomandimi gjithashtu inkurajon Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës që të eksplorojnë mënyra të reja për të zhvilluar një rol më të fortë dhe pjesëmarrje kuptimplotë të IKDNJ-ve dhe Rrjetit European të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI-t) në Këshillin e Evropës. Ky rekomandim përbën një instrument i cili sjell standarde të reja dhe nxit praktikën e mira, duke njohur rolin e institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut por edhe të organizatave të shoqërisë civile si promovues të të Drejtave të Njeriut.
3. Shtetet duhet të garantojnë vënien në dispozicion të autoriteteve mbikëqyrës në nivel kombëtar të burimeve të duhura që mundësojnë ushtrimin e mandatit me efektivitet, përfshirë këtu financimin dhe burimet njerëzore. Burimet e vëna në dispozicion të këtyre autoriteteve duhet të garantojnë veçanërisht burime të mjaftueshme njerëzore me eksperiencë dhe njohuri të thelluara të çështjeve dhe teknologjive të inteligjencës artificiale, përpunimit të të dhënave dhe të drejtave të njeriut.

¹ Recommendation CM/Rec(2021)1 of the Committee of Ministers to member States on the development and strengthening of effective, pluralist and independent national human rights institutions. https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectId=0900001680a1f4da.

4. Autoriteti mbikëqyrës në nivel kombëtar duhet të ketë mandat dhe pushtet të mjaftueshëm, përfshirë por pa u kufizuar në kompetencën për të zhvilluar hetime administrative, për të trajtuar ankesa, por edhe për të raportuar mbi gjendjen faktike e për të ushtruar aktivitet promovues në përputhje me Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për impaktin e sistemeve algoritmike në të drejtat e njeriut². Duke mbajtur në konsideratë nevojën për transparencë por edhe për kuptueshmërinë e duhur të algoritmave, autoritet mbikëqyrës duhet të jetë i mandatuar për të promovuar ndërgjegjësimin publik, transparencën dhe llogaridhënien.
5. Nisur nga impakti që mund të kenë sistemet e inteligjencës artificiale në të drejtat individuale, por edhe në shoqëri në tërësi, përfshirë dhe në vlerat thelbësore të demokracive liberale, nevojitet që të nxitet përfshirja e shumë grupeve të interesit në nivel kombëtar. Zhvillimi dhe përdorimi i sistemeve të inteligjencës artificiale – çka po rritet dita-ditës në të gjithë fushat e jetës – do të ristrukturojë në terma afatshkurtër e afatgjatë mënyrën se si funksionon shoqëria, çka sjell si domosdoshmëri përfshirjen e shumë aktorëve për të përcaktuar se cilat do të jenë kufijtë dhe kushtet e përdorimit të këtyre sistemeve. Nga kjo pikëpamje, është veçanërisht e rëndësishme të institucionalizohet bashkëpunimi me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, ekspertët e kërkimit shkencor, apo përfaqësuesit e personave të prekur nga përdorimi i këtyre sistemeve.

Për sa më lart, sugjerojmë që rekomandimet e mësipërme të mbahen në konsideratë gjatë pjesëmarrjes apo angazhimit në sesionet e diskutimit të kapitujve të draft-konventës. Institucioni i Avokatit të Popullit do të përcjellë në vijimësi sugjerimet përkatëse edhe për sa i takon kapitujve të tjerë të Konventës, sipas axhendës së planifikuar për diskutim në Komitetin e Inteligjencës Artificiale.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Vilma SHURDHA

² Recommendation CM/Rec(2020)1 of the Committee of Ministers to member States on the human rights impacts of algorithmic systems. https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectid=09000016809e1154